



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kml.nr.10/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Valdete Daka dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit S.N., për shkak të kundërvajtjes nga neni 36.3 pika (b) të Ligjit për Pyjet e Kosovës nr.2003/3, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës KA.nr.178/2021 datë 19.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17 gusht 2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës KA.nr.178/2021 i datës 19.04.2021, dhe çështja i kthehet gjykatës së njëjtë në rivendosje.

A r s y e t i m i

Në procedurën kundërvajtëse Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin K.nr.5-133/2020 e datës 18.02.2021, e ka gjet përgjegjës të pandehurin S.N., për shkak të kundërvajtjes nga neni 36.3 pika (b) të Ligjit për Pyjet e Kosovës nr.2003/3, dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €. I pandehuri është i obliguar që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguajë shumën prej 5 €, e në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Masa drunore e llojit të bungut në gjatësi 0.30 m, në vëllim të përgjithshëm prej 1.40 m³, e sekuestruar sipas procesverbalit mbi kryerjen e kontrollit inspektues nga Inspektorati Qendror i Pyjeve me nr.000707 datë 22.01.2020, është konfiskuar.

E dëmtuara Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Qendror i Inspektoratit për Pylltari dhe Gjueti, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin KA.nr.178/2021 e datës 19.04.2021, e ka hedhur poshtë ankesën e paraqitur nga e dëmtuara si kërkesë e dorëzuar pas afatit.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me parashtrësën KMLK.nr.13/2021 e datës 12.07.2021, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtse nga neni 139 par.2 të Ligjit për Kundërvajtje dhe ka propozuar që aktvendimi i shkallës së dytë të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së njëjtë për rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe nenit 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë Prokurori i Shtetit pretendon se aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të procedurës kundërvajtëse nga neni 139 par.2 të Ligjit për Kundërvajtje meqenëse gjykata e shkallës së dytë duke vendosur dhe duke shqyrtuar afatin e paraqitjes së ankesës kundër vendimit të shkallës së parë, gabimisht ka zbatuar dispozitat ligjore duke konsideruar se ankesa është paraqitur pas afatit. Prokurori i Shtetit pretendon se e dëmtuara Agjencia Pyjore e Kosovës aktgjykimin e shkallës së parë e ka pranuar me datë 25.02.2021 ndërsa ankesën kundër këtij aktgjykimi e ka dërguar në Gjykatën e Apelit përmes Postës me datën 03.03.2021 që do të thotë brenda afatit ligjor prej 8 ditësh, e jo ashtu siç ka vendosur gjykata e shkallës së dytë duke konstatuar e ankesa është dorëzuar me 08.03.2021.

Kjo gjykatë duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe duke i shqyrtuar shkresat e çështjes gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të dëmtuarës i është dorëzuar me 25 shkurt 2021, ndërsa ankesa siç vërtetohet nga shkresat të cilat gjenden në dosjen e kësaj çështjeje respektivisht nga plikojat me të cilin është dorëzuar ankesa në Gjykatën e Apelit vërtetohet se kjo ankesë është dorëzuar në Postë me datën 08.03.2021. Mirëpo kjo vulë e pranimit është vula kur është pranuar ankesa në postë, ndërsa vula e dorëzimit është e palexueshme. Andaj, kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së dytë nuk e ka vërtetuar saktësisht se kur është dorëzuar në Postë ankesa e të dëmtuarës pra a është dorëzuar brenda afatit ligjor prej 8 ditësh. Andaj, kjo gjykatë, konsideron se gjykata e shkallës së dytë, meqenëse në shkresat e çështjes nuk ka dëshmi mbi bazën e të cilave mund të vërtetohet saktësisht data e dorëzimit të ankesës, është dashur që nga posta të kërkojë dëshmi se kur është dorëzuar ankesa e pastaj të vendos lidhur me afatshmërinë apo eventualisht edhe për meritat e ankesës.

Në rigjykim gjykata e shkallës së dytë duhet së pari të vërtetohet saktësisht datën e dërgimit të ankesës e pastaj varësisht nga ky fakt të vendos lidhur me afatshmërinë apo edhe për pretendimet ankimore.

Andaj, duke u bazuar mbi të gjitha këto që u tha më lart e konform dispozitës së nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

KML.nr.10/2021, më 17 gusht 2021

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta